



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

Nr. 382 prot.

Tiranë, më 21 tetor 2019

**Vendim**

Nr. 23, datë 21.10 2019

*Për shpalljen e të nominuarve të konkursit për veprën shkencore më cilësore kushtuar antifashizmit në Shqipëri (1991-2019) të akorduar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë*

Juria ndërkombëtare e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më të realizuar kushtuar antifashizmit në Shqipëri (nga viti 1991 deri më 2019), organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e mbledhur sot më datë 21 tetor 2019 në Akademinë e Shkencave, në përmbushje të përgjegjësive të veta dhe referuar:

- Ligjit nr. 53/2019, datë 18.07.2019, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë" neni 7, pika 8;
- Urdhrit Nr. 11, datë 6 tetor 2016 "Rregullore për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të Konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre", neni 13;
- Vendimit të Kryesisë së ASH-së nr. 14, datë 24.07.2019 "Për shpalljen e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, botuar në periudhën 1991-2019 në kuadër të përkujtimit të 75-vjetorit të antifashizmit në Shqipëri;
- Vendimit të Kryesisë së ASH-së nr.15, datë 25.07.2019 "Për formimin e jurisë së konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, botuar në periudhën 1991-2019",

Pasi secili prej antarëve të saj u njoh me veprat e paraqitura në konkursin e çmimeve, pas diskutimeve të antarëve dhe votimit të fshehtë, në mbledhjen e saj të datës 21 tetor 2019,

### Vendosi:

1. Të shpallë të nominuar për *Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga autorë vendës*, këto vepra:

Nr.	Titulli i veprës	Autori
1.	<b>Dosjet e luftës</b>	Ana Lalaj
2.	<b>Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944 – korrik 1945),</b>	Lefter Nasi
3.	<b>Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore – Libri 1: 1939-1943</b>	Paskal Milo
4.	<b>Shqipëria dhe "Tokat e lirueme": 1939-1946</b>	Romeo Gurakuqi

2. Të shpallë të nominuar për *Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga autorë të huaj (të përkthyer në shqip)*, këto vepra:

Nr.	Titulli i veprës	Autori
1.	<b>Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945</b>	Bernd J. Fischer
2.	<b>Qëndresë dhe bashkëpunim në Shqipëri : 1939-1944 : një analizë historike e gjedhes kulturore të mikut dhe armikut</b>	Hubert Neuwirth
3.	<b>Fitorja e hidhur - Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë</b>	Reginald Hibbert
4.	<b>Lufta e fshehtë në Shqipëri – një histori e misionëve sekrete britanike 1940 – 1945</b>	Roderick Bailey

3. Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga studiues të rinj, nuk ka asnjë botim që plotëson këto kritere.
4. Shpallja e nominimeve do të njoftohet publikisht në media.
5. Mbledhja e Jurisë për përzgjedhjen e fituesve do të bëhet më datë 14. 11. 2019, me votim të fshehtë e do të shpallen më datë 15. 11. 2019, në një ceremoni të veçantë.
6. Ngarkohet sekretaria e Jurisë, specialisti i IT-së specialisti i komunikimeve shkencore për publikimin e këtij vendimi pas shpalljes publike të tyre.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### JURIA E ÇMIMEVE:

**Kryetar:** Akad. Marenglen Verli



**Anëtar:** Prof. Jusuf Bajraktari



**Anëtar:** Prof. Valentina Duka



**Anëtar:** Prof. Mario Brunetti



**Anëtar:** Prof. Hamit Kaba

